

Protokolli i Bournemouth-it për mbrojtjen dhe hetimin e varreve masive



© 2020 Melanie Klinkner dhe Ellie Smith
Të gjitha të drejtat e rezervuara.
ISBN: 9781858993218
Imazhi i kopertinës ©

Parathënie

nga Madhëria e Saj Mbretëresha Noor, Komisionere e Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur

Si Komisionere e Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) që nga viti 2001, kam qenë e privilegjuar dhe e inkurajuar për të dëshmuar ndryshimin historik drejt përgjegjësisë së shtetit në dhënien e llogarive për personat e zhdukur në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës.

Në vitet '90, institucionet e drejtësisë në vend dhe ato ndërkombëtare filluan të hetojnë mijëra raste dhe varre masive përkatëse në ish-Jugosllavi. Kjo hodhi themelet për strategjitë që mbështeten në shtetin e së drejtës për të siguruar të drejtat e të mbijetuarve dhe për të nxitur besimin e publikut në kapacitetin dhe vullnetin e qeverive për të vazhduar hetime efikase dhe të drejta për personat e zhdukur. Këto hetime përfshinë përdorimin e vazhdueshëm të mjeteve shkencore për të gjetur dhe për të identifikuar të zhdukurit. Është bërë gjithashtu evidente në të njëjtën periudhë se hetimet e duhura për rastet e personave të zhdukur në shkallë të gjerë, për shkak të konflikteve, abuzimeve me të drejtat e njeriut, fatkeqësive, krimet të organizuar apo migrimin, është një investim në kohezionin social, si dhe në rikuperimin dhe parandalimin e konflikteve, në paqen e qëndrueshme dhe në sigurinë e njerëzve.

Detyrimi për të kryer hetime efikase për shkeljet dhe abuzimet me të drejtat e njeriut i takon shteteve, pavarësisht se kush ka kryer shkelje dhe abuzime të tilla. Moskryerja e hetimeve për rastet e personave të zhdukur në mënyrë efikase, duke përfshirë rrethanat e zhdukjes, përbën shkelje të të drejtave themelore të njeriut për personat e zhdukur dhe anëtarët e familjeve të tyre. Është gjithashtu një shmangie e rrezikshme nga shteti i së drejtës. Prandaj, hetimet efikase përfaqësojnë një angazhim autentik dhe të domosdoshëm për të trajtuar trashëgiminë e krimeve të së kaluarës.

Në vitin 2008, një botim i përgatitur nën drejtimin e studiuesve të Universitetit të Bournemouth-it prezantoi një përmbledhje të parë të përvojave dhe mësimave të nxjerra nga hetimi shkencor i varreve masive. Kjo ishte një sipërmarrje bashkëpunimi e orientuar drejt hartimit të Procedurave Standarde Operacionale. *Protokolli i ri i Bournemouth-it për Mbrojtjen dhe Hetimin e Varreve Masive* vazhdon këtë strategji kërkimore, duke përfshirë punën e ekspertëve ndërkombëtarë që përfaqësojnë një sërë disiplinash dhe organizatash, për të përcaktuar standardet për këtë çështje thelbësore.

Protokolli i Bournemouth-it për Mbrojtjen dhe Hetimin e Varreve Masive mbështetet fort në premisën se standardet e

hetimit dhe mbrojtjes që zbatohen për varret masive duhet të mbështesin përpjekjet për të përcaktuar të vërtetën për atë që ndodhi dhe për të lehtësuar ndjekjen e drejtësisë. Vetëm nëpërmjet hetimeve shteti i jep kuptim garancive të të drejtave të njeriut. Hetimet penale rregullisht udhëheqin përpjekjet për gjetjen dhe zhvarrosjen e varreve masive pas konflikteve të armatosura, shkeljeve dhe abuzimeve me të drejtat e njeriut dhe akteve të tjera kriminale. Ato fokusohen në sigurimin e provave për krimet e kryera dhe janë pjesë e projektit më të madh të cilësuar nga gjykatat si e drejta për një hetim efikas. *Protokolli i Bournemouth-it për mbrojtjen dhe hetimin e varreve masive* është një hap i rëndësishëm përpara në sigurimin e qartësisë mbi normat dhe standartet ndërkombëtare. Ai do të mundësojë një bashkëpunim më të madh ndërmjet organizatave në një sërë mjedisesh. Varret masive dhe vendet ku ka ndodhur dhuna e tmerrshme dhe humbjet njerëzore duhet të mbrohen nga ndërhyrjet dhe të hetohen sipas standardeve që janë të ligjshme dhe të respektueshme. Këtë ia detyrojmë familjeve të viktimave dhe shoqërisë në tërësi.

Protokolli i paraqitur këtu u frymëzua dhe i detyrohet shumë aktorëve të përfshirë në proceset e mbrojtjes dhe hetimit të varrezave masive, nga disipinat ligjore, hetimore dhe shkencore të ndërlidhja me komunitetin dhe mbështetja familjare, secila me rregullat dhe standartet e veta të praktikës profesionale. Në emër të ICMP-së, kam kënaqësinë e madhe t'iu prezantoj *Protokollin e Bournemouth-it për Mbrojtjen dhe Hetimin e Varreve Masive*.



Madhëria e saj Mbretëresha Noor
Komisionere e Komisionit Ndërkombëtar
për Personat e Zhdukur

Hyrje

nga Dr. Agnes Callamard, Relatore e Posaçme e OKB-së për ekzekutimet jashtëgjyqësore dhe arbitrare

Varret masive nuk janë aksidente të izoluara të historisë njerëzore. Ato janë të shpërndara në të gjithë globin dhe në çdo rajon. Disa u përkasin shekujve të kaluar, ndërsa të tjerat janë zbuluar vetëm kohët e fundit. Megjithatë, të gjitha kanë histori të rëndësishme për të treguar – të vërteta që shpesh janë lënë të pathëna, të mohuara, të mbuluara ose të varrosura. Si Relatore e Posaçme e OKB-së, e fokusuar në të drejtat e njeriut në kontekstin e ekzekutimeve jashtëgjyqësore dhe vrasjeve pa gjyq ose arbitrare, e di se varret masive mund të jenë rezultat i konflikteve të armatosura, të lidhura me aktivitete kriminale ose rezultat i mospërfilljes së detyrave shtetërore. E di gjithashtu se vendndodhjet e vrasjeve masive dhe varreve masive janë vende ku mund të jenë kryer shkelje të shumta të të drejtave të njeriut, ndoshta në mënyrë të përsëritur, me kalimin e kohës.

Kuptimi personal, fetar, kulturor dhe historik i vendndodhjes së një varri masiv dhe ngjarjet që lidhen me krijimin e tij ndryshojnë nga vendi në vend, nga individi në individ, nga komuniteti në komunitet, nga shteti në shtet. Por, rëndësia e tyre është përtej konflikteve dhe kapërcen kufijtë dhe brezat. E bën ruajtjen dhe përkujtimin e varreve masive një detyrë të të gjitha brezave, të të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes, për të lejuar lamtumirën e fundit dinjitoze dhe dhënien e nderimeve të fundit. Prandaj, në asnjë rrethanë nuk duhet të mohohet apo mbulohet ekzistenca e një varri masiv, as nuk duhet të dëmtohet apo shkatërrohet vendndodhja. Në asnjë rrethanë ata që kërkojnë apo flasin për varre masive nuk duhet të burgosen, kërcënohen apo detyrohen për të heshtur. Përkundrazi, duhet të ndërmerret një qasje gjithëpërfshirëse bazuar në të drejtat e njeriut. Është i nevojshëm trajtimi, menaxhimi dhe administrimi që ruan dinjitetin e të vdekurve, lehtëson sa më shumë vuajtjet e familjeve dhe komuniteteve, mundëson kërkimin e së vërtetës dhe drejtësisë dhe nënkupton për të gjithë një angazhim të qëndrueshëm për mospërsëritje.

Protokolli i Bournemouth-it për mbrojtjen dhe hetimin e varrezave masive është një kontribut i madh për këtë qëllim. Ai ofron një përkufizim shumë të nevojshëm të varrezave masive dhe bashkon degët e së drejtës ndërkombëtare që mbështesin përpjekjet e ligjshme dhe të respektueshme për mbrojtjen dhe hetimin në mënyra të tilla që të sjellin përfitime për familjet në ushtrimin e të drejtave të tyre njerëzore për të vërtetën

dhe drejtësinë. Protokolli jep argumenta për një angazhim më të fuqishëm të gamës së plotë të normave, standarteve dhe ligjeve për të drejtat e njeriut të zbatueshme për varret masive, trajtimin e mbetjeve njerëzore dhe interesat e familjeve, të të mbijetuarve, komuniteteve dhe kombeve të prekura. Në zbatim, Protokolli do të ndihmojë për të siguruar se varret masive dhe mbetjet njerëzore që gjenden aty, do të marrin trajtimin e respektueshëm, jodiskriminues dhe dinjitoz që meritojnë që nga pika e zbulimit dhe hetimit fillestar deri në përpjekjet për identifikim dhe deri në ndjekjen më të plotë të drejtësisë zyrtare dhe përkujtim më afatgjatë.

Si komunitet ndërkombëtar, trajtimi i varrezave masive nga ana jonë ka qenë shpesh i papërshtatshëm, diskriminues ose, thjesht, indiferent. Nuk duhet të jetë më kështu. Ne mund dhe duhet të bëjmë shumë më mirë dhe më shumë, për të respektuar dhe për të mbrojtur interesat dhe shqetësimet e ndryshme të familjeve, të mbijetuarve, komuniteteve dhe shoqërive. Është detyra jonë e përbashkët ndaj njerëzimit.



Dr Agnes Callamard
Relatore e Posaçme e OKB-së për
Ekzekutimet Jashtëgjyqësore dhe Arbitrare



**UNITED NATIONS
HUMAN RIGHTS
SPECIAL PROCEDURES**

SPECIAL RAPPORTEURS, INDEPENDENT EXPERTS & WORKING GROUPS

**Mandati i Relatores së
Posaçme për Ekzekutimet
Jashtëgjyqësore dhe Arbitrare**



Përmbajtja

Qëllimi dhe objekti i Protokollit	3
Parimet operative gjithëpërfshirëse në mbrojtjen dhe hetimin e varreve masive.....	6
A. Zbulimi dhe raportimi i sigurt.....	8
B. Mbrojtja	8
C. Hetimi.....	9
D. Identifikimi	12
E. Kthimi i mbetjeve njerëzore	14
F. Drejtësia.....	15
G. Përkujtimore	16
Shtojca 1.....	17
Shtojca 2.....	18
Shtojca 3.....	19
Shtojca 4.....	20
Shtojca 5.....	21
Shtojca 6.....	22

Qëllimi dhe objekti i Protokollit

Varret masive janë një trashëgimi shumë e shpeshtë e konflikteve dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. Për të mbijetuarit, nevoja për të ditur fatin dhe vendndodhjen e njerëzve të dashur, si dhe për të marrë mbetjet mortore për varrim dhe/ose përkujtim dinjitoz, mund të jetë dërmuese. Gjithnjë e më shumë kjo nevojë po njihet si një e drejtë ligjore për të ditur të vërtetën.

Varret masive përmbajnë prova që janë thelbësore për të kuptuar në mënyrë efektive të vërtetën, drejtësinë dhe përgjegjësinë e autorit. Prandaj, rregullat dhe procedurat efektive për mbrojtjen, ruajtjen dhe hetimin e varreve masive janë thelbësore. Aktualisht, megjithatë, ndërsa ekzistojnë një sërë qasjesh të praktikave më të mira në veprim midis aktorëve të ndryshëm në këtë fushë, nuk ekzistojnë standarte universale ose të përbashkëta. Nëpërmjet një procesi pjesëmarrës dhe konsultativ, ky Protokoll e plotëson këtë boshllëk. Ai as nuk dublikon dhe as nuk zëvendëson dokumentet ekzistuese për parimet dhe praktikën e mira¹. Në vend të kësaj, ai ofron një qasje unifikuese ndërdisiplinore për mbrojtjen dhe hetimin e varreve masive. Ai ndjek kronologjinë e këtyre proceseve në tërësinë e tyre me një mori aktorësh, disiplinash dhe mekanizmash të bashkuar për qëllimin e dyfishtë dhe reciprokisht fuqizues të përparimit të së vërtetës dhe drejtësisë, duke ofruar:

(1) Një Protokoll Ndërkombëtar për Mbrojtjen dhe Hetimin e Varreve Masive, i fokusuar në dispozitat ligjore përkatëse, që kombinon dhe lidh degët e së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe - aty ku është e zbatueshme - të drejtës penale ndërkombëtare; dhe

¹ Shih listën e dokumenteve të tilla relevante në Shtojcën

(2) një Komentari Akademik të Protokollit, duke pasqyruar bazat dhe diskutimet që çuan në dispozitat e ndryshme të përfshira në të. Komentari Akademik, i botuar veçmas, thekson dhe zgjeron perspektivat dhe nevojat konkurruese që lindin në procesin e mbrojtjes dhe hetimit të varreve masive për të siguruar që, në praktikë, ato janë të parashikuara dhe, kur është e mundur, të zbuten.

Përdoruesit: Protokollin synohet të përdoret nga specialistë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: zyrtarët e qeverisë dhe shtetit, personelin ligjzbatues, përfaqësuesit ligjorë, ekspertët mjeko-ligjorë, profesionistët shëndetësorë, personelin e sigurisë dhe aktorët ekspertë të shoqërisë civile.²

Objekti dhe zbatimi i Protokollit: rast pas rasti

Detyra kontekstuale e këtij Protokollit është e kufizuar në varrezat masive që lidhen me kontekstin e abuzimeve dhe konflikteve të rënda të të drejtave të njeriut, brenda dhe jashtë vendit.

Megjithatë, kjo nuk përjashton që Protokollin të jetë i përshtatshëm për varret masive që lidhen edhe me situata të tjera.³

Viktimat në varrezat masive mund të jenë burra, gra dhe/ose fëmijë. Ata mund të jenë civilë dhe/ose luftëtarë të armatosur nga të gjitha palët e një konflikti. Protokollin synohet të zbatohet pa dallime dhe pavarësisht nga opinioni politik apo opinione të tjera, lidhja me një pakicë kombëtare, gjini, orientim seksual, identitet gjinor, fe ose besim, pavarësisht nga mosha, raca, ngjyra, gjuha, etnia, kasta, origjina kombëtare ose sociale, aftësitë e kufizuara fizike ose mendore, statusi shëndetësor, pasuria, lindja, statusi martesor ose çdo bazë tjetër e njohur nga instrumentet ligjore ndërkombëtare.

Nuk ekziston një gjë e tillë si një hetim ose zhvarrosje “standarte” apo “tipike” e varrit masiv. Hetimet për varre masive janë shumë specifike në kontekst. Kjo mund të jetë për shkak të faktorëve të tillë si juridiksioni gjeografik dhe kohor, si dhe mjedisi politik. Si rezultat, ky Protokoll nuk synohet të jetë urdhërues për sa i përket praktikave më të mira thelbësore në të gjitha rastet e zhvarrimit të varreve masive. Përkundrazi, Protokollin ofron konsiderata specifike që synojnë të mbështesin dhe informojnë specialistët teksa ata angazhohen në një proces hetimor në kapacitetet e tyre të ndryshme dhe në të gjitha fazat. Për këtë qëllim, duhet theksuar se konsideratat e përfshira në këtë Protokoll mund të mos zbatohen në tërësinë e tyre për çdo hetim. Ndërsa Protokollin është hartuar për të ndihmuar në nivel universal, përcaktimi i zbatueshmërisë së aspekteve specifike të Protokollit duhet të bëhet nga specialisti

rast pas rasti.

Duke pasur parasysh të gjitha këto, në një nivel minimal dhe në varësi të mjeteve, standartet e hetimit dhe të mbrojtjes që zbatohen në çdo situatë duhet të jenë të mjaftueshme për të përmbushur qëllimet e së vërtetës dhe të drejtësisë, d.m.th. ato duhet t'i rezistojnë shqyrtimit autoritar.

Metodologjia

Përmbajtja e Protokollit është hartuar në bazë të përvojës dhe kontributit të ekspertëve të ftuar, duke përfshirë ekspertë mjeko-ligjorë, hetues, gjyqtarë, prokurorë, personel sigurie/polici, përfaqësues të shoqërisë civile dhe akademike, duke reflektuar përvojën e mbrojtjes dhe hetimit të varreve masive, ekspertizën në të drejtat e njeriut, të drejtën humanitare dhe/ose penale, si dhe diversitetin gjeografik.⁴

Përkufizimet

- Për qëllimin e Protokollit, ne parashtrojmë përkufizimet e mëposhtme të punës:
- Termi varr masiv, i papërcaktuar në të drejtën ndërkombëtare, përdoret këtu për të nënkuptuar “një vend ose zonë të përcaktuar që përmban një mori (më shumë se një) mbetjesh njerëzore të varrosura, të zhytura ose të shpërndara në sipërfaqe (duke përfshirë mbetjet e skeletizuara, të përziera dhe të fragmentuara), ku rrethanat që kanë të bëjnë me vdekjen dhe/ose metodën e asgjësimit të trupit garantojnë një hetim për ligjshmërinë e tyre”.
- Persona të zhdukur do të thotë “persona të zhdukur si rezultat i konfliktit, abuzimit me të drejtat e njeriut dhe/ose dhunës së organizuar”⁵.
- Me viktimë, Protokollin nënkupton “personat që, individualisht ose kolektivisht, kanë pësuar dëmtime, duke përfshirë lëndime fizike ose mendore, vuajtje emocionale, humbje ekonomike ose dëmtim të konsiderueshëm të të drejtave të tyre themelore, nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve që janë në kundërshtim me ligjet penale operative në Shtetin përkatës ose si rezultat i akteve që përbëjnë shkelje të rënda të ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut ose shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare”⁶. Në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, përkufizimi i viktimës i përdorur në Protokoll përfshin jo vetëm individët që ndodhen në një varr masiv (viktima “parësore” ose “direkte”), por edhe familjet e tyre dhe, aty ku është e rëndësishme, komunitetet (viktimat “dytësore” ose “indirekte”). Për hir të qartësisë, ky Protokoll u referohet gjithashtu “familjeve”, “anëtarëve të familjes” dhe “komuniteteve të prekura” ku dispozita të veçanta u përkasin atyre.⁷

² Kjo mund të përfshijë iniciativat e mjekësisë ligjore qytetare kur ato janë nën kujdesin e një organizate eksperte të autorizuar të shoqërisë civile. Iniciativat politike gjithashtu mund të “legjitimojnë” të mbijetuarit që mund të përfshihen në procesin hetimor dhe të zhvarrosjes dhe që mund të mos jenë profesionistë, por ndërmarrin zhvarrosje. Për një diskutim të mëtejshëm, shihni Komentarin Akademik shoqëruar.

³ P.sh. fatkeqësitë, duke përfshirë fatkeqësitë e shkaktuara nga njeriu dhe vdekjet si rezultat i zbatimit të ligjit për kufirin ose trafikimit.

⁴ Informacionet mbi teknikën e kampionimit për përfshirjen e ekspertëve mund të gjenden në Komentarin Akademik shoqëruar.

⁵ Përshtatur nga Unioni Ndërparlamentar dhe ICRC (2009), Personat e Zhdukur – Një Manual për Parlamentarët në faqen 9 dhe në përputhje me mandatin e Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur. Ashtu si me varrezat masive, nuk ka një përkufizim të vetëm për personat e zhdukur. Përkufizimi i sugjeruar këtu është më pak i ngushtë në konceptualizim sesa ai që gjendet në Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së të vitit 2019 për Personat e Zhdukur si rezultat i Konfliktit të Armatosur, i cili i bën jehonë përkufizimit të UNHCR-së të vitit 2010 për personat “e pagjetur si rezultat i një konflikti të armatosur ndërkombëtar ose jo ndërkombëtar (paragrafi 9). Në të njëjtën kohë, përkufizimi këtu nuk përfshin shprehimisht migrantët e zhdukur, një temë përtej mundësive të Protokollit.

⁶ Ky është një përkufizim i përbërë nga Deklarata e OKB-së për Parimet Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Shpërdorimit të Pushtetit, në Shtojcën A, 1, dhe Parimet dhe Udhëzimet Themelore të OKB-së mbi të Drejtën për një mjet juridik dhe dëshmipërblim për viktimat e shkeljeve të rënda të Ligjit Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut dhe Shkeljet e Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare, Shtojca V, 8 dhe i bën jehonë nenit 24(1) të Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyrur.

⁷ Aty ku flitet shprehimisht për “familjet”, “anëtarët e familjes” ose “komunitetet e prekura”, nuk synohet asnjë mënyrë sugjerimi se ata nuk janë viktimat gjithashtu. Përveç kësaj, pranohet se anëtarët e familjes dhe komunitetit mund të jenë vetë viktimat të drejtpërdrejta të dëmeve të tjera të shkaktuara në kontekstin më të gjerë të shkeljeve nën hetim, pjesë e të cilave janë varret masive.

- Termi familje, i papërcaktuar në të drejtën ndërkombëtare, përdoret këtu si një koncept që lidhet me praktikën shoqërore në një kontekst specifik.⁸ Për qëllimin e këtij Protokollit, anëtarësimi në familje është i rëndësishëm për përcaktimin, për shembull, të të afërmeve⁹, marrësit të duhur të mbetjeve mortore dhe lëshimin e dokumentacionit të statusit ligjor për një person të zhdukur. Anëtarësia familjare duhet të përcaktohet sipas ligjeve, zakoneve dhe/ose praktikave lokale.
- Mjekësia ligjore (e vërtetë me kuptimin e saj të mirëfilltë “në gjykatë të hapur” ose “publik”) nënkupton sferën shkencore, ligjore dhe shoqërore duke i sjellë çështjet para gjykatave të drejtësisë dhe/ose mekanizmave të tjerë gjyqësorë (si p.sh. një mjek ligjor).

Formati i Protokollit

Dokumenti përfshin proceset e ndryshme kronologjike të zbatueshme për mbrojtjen dhe hetimin e varreve masive duke ndjekur një qasje normative, kështu që përmbajtja e Protokollit ka një bazë të qartë në rregullat dhe parimet ligjore ndërkombëtare. Prandaj, çdo seksion do të fillojë me një kuti blu që përshkruan dispozitat thelbësore normative që rrjedhin nga e drejta ndërkombëtare¹⁰ (normat ndërkombëtare), duke ofruar kështu arsyetimin ligjor për përmbajtjen e sugjeruar të Protokollit.

Baza ligjore

Pika e fillimit për Protokollin në tërësi është detyrimi i shteteve për të kërkuar dhe hetuar.

Normat ndërkombëtare

Detyra për të kërkuar dhe hetuar

Sipas ligjit për të drejtat e njeriut, shtetet kanë për detyrë të kërkojnë dhe hetojnë kur është shkelur e drejta e një individi dhe mbrojtja e asaj të drejte.

E drejta për të jetuar dhe ndalimi i torturës ose trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese përfshijnë aspekte procedurale që kërkojnë një hetim efikas (ICCPR¹¹, nenet 6 dhe 7). Sipas ligjit rajonal të të drejtave të njeriut, një hetim duhet të jetë i shpejtë, i pavarur, i plotë, i paanshëm dhe transparent. Gjetjet e tij duhet të mbështeten në një analizë të plotë, objektive dhe të paanshme të të gjithë elementëve përkatës.¹²

Neni 24(3) i Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar (CED¹³) kërkon nga shtetet palë të marrin të gjitha masat e duhura për të kërkuar, lokalizuar dhe liruar personat e zhdukur dhe, në raste vdekjesh, për të gjetur, respektuar dhe kthyer eshtrat e tyre. Është një detyrim i vazhdueshëm derisa të përcaktohet fati dhe/ose vendndodhja e të zhdukurve (Parimet udhëzuese të CED¹⁴, Parimi 7). Në përgjithësi, detyra për të kryer një hetim efikas është një detyrim mjeteshe dhe jo rezultatesh.¹⁵

E drejta ndërkombëtare humanitare përfshin kërkimin e të vdekurve (për shembull, KP I, neni 15; KP II, nenet 18 dhe 21; KP IV, neni 16; Protokoll i Shtesë I, Neni 17(2)) dhe të zhdukurit (Protokoll i Shtesë I, Neni 33(2)).¹⁶ E drejta zakonore ndërkombëtare humanitare sugjeron se çdo palë në konflikt, qoftë ajo ndërkombëtare apo e brendshme, është e detyruar “të marrë të gjitha masat e mundshme për të llogaritur personat e raportuar të zhdukur si rezultat i konfliktit të armatosur” (Rregullat CIHL¹⁷ 2006, Rregulli 117).

Ndërkohë që pranohet se varret masive mund të gjenden në kontekste me mekanizma të pajisur keq ose jo-ekzistues, një gjyqësor i mbingarkuar, me pasiguri dhe një mori nevojash konkurruese, të njëkohshme, ekziston një kërkesë e shprehur për legjislacion vendas dhe krijimin e institucioneve të dedikuara. Legjislacioni dhe institucione të tilla shihen si kushte paraprake për një përgjigje efektive për të gjitha rastet e personave të zhdukur.

Normat ndërkombëtare:

Legjislacioni për Personat e Zhdukur dhe Autoriteti i Dedikuar për Personat e Zhdukur

The CED requires relevant authorities to have official records and registers of all persons deprived of their liberty (Article 17(3)). Registers and database management should respect the privacy of victims and confidentiality of information (CED-Guiding Principle, 11(8)).

⁸ Ligji model i KNKK-së për të Zhdukurit përdor termin “i afërm i personave të zhdukur” duke iu referuar dhe në përputhje me dispozitat e legjislacionit vendas në fuqi (Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) (2009), Parimet Udhëzuese/Ligji Model për të Zhdukurit, Neni 2(2)) (shkurtuar Ligji Model i KNKK-së për të Zhdukurit).

⁹ Përfshirë të afërmit e drejtpërdrejtë dhe të lidhur gjenetikisht (Pueblo Bello Massacre Columbia, Gjykimi mbi meritat, dëmshpërblimet dhe kostot, Gjykata Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut Seria C Nr. 140 (31 janar 2006) paragrafet 273 dhe 274.

¹⁰ Prandaj, lista e dispozitave normative mund të jetë vetëm indikative.

¹¹ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (miratuar më 19 dhjetor 1966, hyrë në fuqi më 23 mars 1976) 999 UNTS 171 (shkurtuar ICCPR). Shih gjithashtu Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut (HRC), Komenti i Përgjithshëm nr. 36, Neni 6 (E Drejta për të jetuar) CCPR/C/GC/35 (3 shtator 2019) paragrafi 58.

¹² Kukhalashvili dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë, Vendimi, Kërkesat Nr. 8938/07 dhe 41891/07 të GJEDNJ-së (2 maj 2020) paragrafi 130.

¹³ Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Detyruar (miratuar më 12 janar 2007, hyrë në fuqi më 23 dhjetor 2010) UN Doc A/RES/61/177 (20 dhjetor 2006) (shkurtuar CED).

¹⁴ Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Zhdukjet e Detyruara, Parimet Udhëzuese për kërkimin e personave të zhdukur (8 maj 2019) Dokumenti i OKB-së CED/C/7, Parimi 7 (këtu e më tej, Parimet Udhëzuese të CED).

¹⁵ Da Silva kundër Mbretërisë së Bashkuar, Vendimi i Dhomës së Madhe, Kërkesa nr. 5878/08 GJEDNJ (30 mars 2016) paragrafët 231–238, duke dhënë një përmbljedhje të plotë të Dhomës së Madhe të kriterëve për një hetim efikas.

¹⁶ Konventa e Gjenevës (I) për Përmirësimin e Gjendjes së të plagosurve dhe të sëmurëve në forcat e armatosura në terren (miratuar më 12 gusht 1949) 75 UNTS 31 (shkurtuar GC I); Konventa e Gjenevës (II) për përmirësimin e gjendjes së anëtarëve të plagosur, të sëmurë dhe të mbytur në det të Forcave të Armatosura (miratuar më 12 gusht 1949) 75 UNTS 85 (shkurtuar GC II); Konventa e Gjenevës (IV) në lidhje me Mbrojtjen e Personave Civile në Kohë Lufte (miratuar më 12 gusht 1949) 75 UNTS 288 (shkurtuar GC IV); dhe Protokoll i Shtesë për Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe Lidhur me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktëve të Armatosura Ndërkombëtare (Protokoll i I) (miratuar më 8 qershor 1977, hyrë në fuqi më 7 dhjetor 1979) 1125 UNTS 17512 (Protokoll i Shtesë i shkurtuar).

¹⁷ Henckaerts J-M. dhe Doswald-Beck L., (2006) E Drejta Ndërkombëtare Humanitare Zakonore, Vëllimi I: Rregullat (Rregullat e CIHL-së të shkurtuara).

Një Autoritet i caktuar i Personave të Zhdukur për bashkërendimin e përpjekjeve për personat e zhdukur (Ligji boshnjak për Personat e Zhdukur¹⁸ Neni 7, shih gjithashtu Parimin Udhëzues të CED-it 12(1) dhe 12(3)) dhe ekspertiza përkatëse e nevojshme, sugjerohet që të përfshijë përgjegjësinë për mbrojtjen e varreve masive, hetimin dhe gjetjen e mbetjeve njerëzore. Ai gjithashtu duhet të ofrojë mekanizma të sigurt për marrjen e kërkesave për gjurmim (Ligji model i KNKK-së për të Zhdukurit¹⁹, neni 12 dhe 12(3)) dhe të krijojë një regjistër të personave të zhdukur dhe informacionet përkatëse.

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së e vitit 2019 thekson nevojën për “ligj në fuqi” (UNSC 2474²⁰ në faqen 2) në nivel vendor për t’iu përgjigjur çështjes së personave të zhdukur. Legjislacioni duhet të jetë jodiskriminues, duke siguruar mbrojtjen, hetimin dhe identifikimin e të gjithë individëve në masën më të plotë të mundshme.

Ndërkohë që autoritetet shtetërore mund të mos kenë gjithmonë struktura para-ekzistuese për të vepruar në rrethanat e jashtëzakonshme të varreve masive përpara konfliktit, abuzimit me të drejtat e njeriut ose fatkeqësive, përsëri mund të ketë një kuadër ligjor të zbatueshëm ku proceset realizohen sipas ligjit, legjislacionit dhe praktikave të vendit të prekur.²¹ Nëse nuk ekziston një mandat ligjor ndërkombëtar që të ketë përparësi, respektimi dhe respektimi i këtyre parimeve ligjore do të zbatohet për të gjithë aktorët. Ata do të rregullojnë çështjen se kush ka të drejtë të kërkojë persona të zhdukur dhe të kërkojë hetimin e varreve masive dhe do të diktojë proceset e kthimit të mbetjeve njerëzore.

Një shënim paralajmërues për mbrojtjen dhe hetimin e varreve masive

Pavarësisht ekzistencës së të drejtave ligjore, hetimet e varreve masive janë detyrime mjeteve dhe jo rezultatesh (d.m.th. përpjekjet më të mira varen nga burimet e disponueshme). Hetimi i varrit masiv është zakonisht një proces shumë kompleks, i gjatë dhe i shtrenjtë, që kërkon planifikim të konsiderueshëm, koordinim, burime, autorizim zyrtar dhe vullnet politik. Vetë hetimi mund të ndikojë tek shumë palë të interesuara, duke përfshirë, por pa u kufizuar në të mbijetuar dhe familje të caktuara; dëshmitarë; grupe viktimash; komunitete të prekura; agjenci të specializuara; OJQ; autoritete dhe agjenci shtetërore lokale, rajonale dhe kombëtare; dhe ente ndërkombëtare si komisionet hetimore të OKB-së dhe organizatat ndërkombëtare. Si rezultat, do të ketë një gamë të gjerë interesash dhe nevojash individuale, kolektive dhe shoqërore, të cilat mund të mos jenë të pajtueshme ose lehtësisht të pajtueshme.

Gjithashtu, në situata të një shkalle të konsiderueshme, mund të mos jetë e mundur të merren, identifikohen dhe riatdhesohen të gjitha viktimat nga një varr masiv dhe kjo mund të ketë implikime për familjet e komuniteteve të zhdukura dhe të prekura.

Mund të ndikojë gjithashtu në perceptimet e drejtësisë dhe veprimtarive të drejtësisë si brenda dhe jashtë vendit, ku zhvarrosja përbën një aspekt të një procesi gjyqësor.²²

Parimet operative gjithëpërfshirëse në mbrojtjen dhe hetimin e varreve masive

Përveç faktorëve që jepen në këtë Protokoll, të cilët zbatohen në faza të ndryshme të procesit të mbrojtjes dhe hetimit, ekzistojnë një sërë parimesh operative gjithëpërfshirëse që duhet të udhëheqin procesin(et) në tërësinë e tyre, duke u zbatuar në të gjitha fazat, për të gjithë aktorët, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Ndonëse renditen veçmas më poshtë, ato janë të ndërlidhura në praktikë.

(1) Mos bëni dëm

Një qasje “mos bëni dëm” mbështet të gjitha parimet e tjera operative dhe kërkon të kuptuarin e mënyrës (ave) të mundshme në të cilat prania dhe kryerja e një hetimi në varr masiv mund të ndikojë në kontekstin dhe mjedisin më të gjerë, së bashku me një vlerësim të mënyrës (ave) në të cilat ndikimet negative mund të shmangen dhe/ose të zbuten aty ku është e mundur.

Si ndërhyrje në të drejtat e njeriut, mjediset e konfliktit dhe pas konfliktit, operacione të tilla në thelb do të jenë pjesë e dinamikës më të gjerë të kontekstit të funksionimit të tyre. Komunitetet mund t’i nënshtrohen ndryshimeve të shpejta shoqërore, të cilat mund të përfshijnë një shkallë rrjedhshmërie në strukturat shoqërore dhe të pushtetit dhe rivendosjen e normave shoqërore. Një qasje “mos bëj dëm” në këto rrethana do të përqipet në mënyrë aktive të shmangë minimin e strukturave dhe marrëdhënieve ekzistuese që janë thelbësore për ruajtjen e paqes dhe bashkëjetesës në komunitet. Ajo duhet të përqipet gjithashtu të shmangë krijimin e pabarazive ose perceptimeve të njëanshmërisë ose favorizimit, duke përfshirë edhe lidhjen me statusin dhe burimet, ose të rrënjosë pabarazitë ekzistuese, duke përfshirë edhe ato në lidhje me gjininë. Ajo do të përfshijë një respekt të qartë dhe, kur është e mundur, respektimin e ndjeshmërive dhe normave kulturore, si dhe besimet e njohura fetare të viktimave dhe/ose familjeve të tyre duhet të merren parasysh sa më shumë që të jetë e mundur dhe në masën që ato nuk ndikojnë negativisht në arritjen e një hetimi efikas.

(2) Siguria fizike dhe emocionale

Siguria fizike dhe emocionale e grupit hetimor, familjeve të të zhdukurve, dëshmitarëve dhe çdo pale tjetër të përfshirë në hetim është parësore.

Siguria, dinjiteti, privatësia dhe mirëqenia e viktimave dhe familjeve të tyre duhet të mbetet një shqetësim kryesor për të gjithë aktorët pa dallim. Kjo mund të kërkojë iniciativë për të mbështetur sigurinë fizike dhe psikologjike, duke përfshirë dhënien e referimeve të duhura dhe miratimin e qasjeve të marra në konsideratë gjatë kryerjes së intervistave me individë potencialisht të traumatizuar. Gjithashtu, duhet pasur kujdes për të minimizuar dhe për t’iu përgjigjur incidencës së traumës së përtjetur dhe ndikimeve të tjera negative emocionale në anëtarët e ekipit.²³

¹⁸ Bosnja dhe Hercegovina: Ligji për Personat e Zhdukur (21 tetor 2004), Gazeta Zyrtare e Bosnjë dhe Hercegovinës 50/04.

¹⁹ Ligji model i KNKK-së për të Zhdukurit.

²⁰ UNSC, Rezoluta 2474, e datës 11 qershor 2019, UN Doc S/RES.2474.

²¹ Shihni, për shembull, Interpol (2018) Udhëzues për identifikimin e viktimave nga fatkeqësitë, Pjesa B, Shtojca 1, në seksionin 4.1.

²² Ndërlidhja me familjen dhe komunitetin, duke përfshirë menaxhimin e pritshmërive, trajtohet në mënyrë më të detajuar më poshtë, në parimet kryesore dhe në seksionin C të këtij Protokolli.

²³ Shihni, për shembull, OHCHR, Manuali për Monitorimin e të Drejtave të Njeriut, Kapitulli 12, i cili përmban udhëzime të hollësishme për intervistimin e individëve të traumatizuar, si dhe për vetëkujdesin.

Duhet të zhvillohen gjithashtu strategji dhe aktivitete specifike për mbrojtjen. Publiku duhet të ndërgjegjësohet për ekzistencën e masave mbrojtëse për të dhënë siguri dhe për të inkurajuar angazhimin e tyre në hetim. Aty ku e lejon situata mbizotëruese e sigurisë, përmbajtja specifike e masave mbrojtëse në lidhje me familjet e viktimave dhe dëshmitarët e mundshëm mund të vendoset gjithashtu në domenin publik. Ata që angazhohen drejtpërdrejt në ndonjë hetim duhet të ndërgjegjësohen për përmbajtjen e masave përkatëse të mbrojtjes, duke përfshirë çdo kufizim në regjimin e mbrojtjes të ofruar, në mënyrë që çdo përfshirje në hetim të bazohet në një vendim të informuar. Respektimi i dinjitetit të viktimave përfshin trajtimin me respekt dhe kujdes të mbetjeve njerëzore.

Çështja e sigurisë duhet të mbahet nën shqyrtim.

(3) Pavarësia dhe paanshmëria

Një qasje jo-diskriminuese dhe e paanshme duhet të zbatohet për të gjithë.²⁴ Në mënyrë që një hetim të perceptohet si legjitim në sytë e një komuniteti të prekur dhe në këtë mënyrë të rritet angazhimi i komunitetit, mbështetja për shtetin e së drejtës dhe llogaridhënien publike, çdo ekip hetimor jo vetëm që duhet të veprojë me pavarësi dhe paanshmëri, por edhe duhet të duket se e bën këtë. Për aq sa është e mundur, ekipet e hetimit duhet të përpiqen të shmangin, kufizojnë ose zbusin situatat që mund t'i bëjnë aktivitetet e tyre të ndjeshme ndaj perceptimeve të paragjyqimeve ose kontrollit politik, fetar ose etnik. Megjithatë, duhet të theksohet se varret masive zakonisht hasen brenda një konteksti politik dhe/ose kulturor shumë të ngarkuar, i cili mund të jetë ende në vazhdim në kohën e hetimit. Si rezultat, ekipet hetimore duhet të jenë të vetëdijshme se zhvarrosja e një varri të caktuar mund të krijojë në vetvete perceptime njëanshmërie në disa sektorë të shoqërisë.

(4) Konfidencialiteti

Garancitë dhe respektimi i konfidencialitetit në lidhje me detajet personale dhe të dhënat e tjera identifikuese mund të jenë kritike në krijimin e besimit dhe garantimin e sigurisë së familjeve të viktimave të dyshuara dhe mund të jenë instrumentale në sigurimin e raportimit të vendeve të mundshme të varreve masive, identitetin e të afërmit të zhdukur dhe sigurimin e të dhënave të personave të zhdukur dhe mostrave të referencës së ADN-së.

Procedurat për konfidencialitet duhet të përcaktohen, kuptohen dhe zbatohen nga të gjithë anëtarët e grupit hetimor. Kushtet e procedurave të konfidencialitetit duhet të jenë në përputhje me dispozitat kombëtare, t'u komunikohen komuniteteve të prekura dhe të bëhen të disponueshme për publikun. Familjet e të zhdukurve dhe anëtarët e tjerë të komunitetit duhet gjithashtu të ndërgjegjësohen për kufijtë e procedurave të konfidencialitetit. Kur proceset e identifikimit dhe/ose hetimit sjellin nevojën ose detyrimin për ndarjen e të dhënave, procesi, natyra dhe qëllimi i ndarjes duhet të bëhen të dukshme në fazën më të hershme të mundshme. Çdo shkëmbim i të dhënave duhet të kufizohet vetëm tek ata individë dhe organe të nevojshme për të siguruar arritjen e objektivave të procesit të zhvarrosjes, dhe në masën e pranuar nga individ(ët) në fjalë.

(5) Transparenca

Të gjitha fazat e procesit të hetimit, zhvarrimit, identifikimit dhe kthimit të mbetjeve njerëzore duhet të jenë sa më transparente për të gjitha palët e përfshira në përpjekjet për mbrojtjen dhe hetimin, familjet e të zhdukurve dhe publikun. Transparenca do të shërbejë për të mbështetur shqyrtimin publik të procesit. Krijimi i procedurave dhe protokolleve formale të qarta, transparente dhe të aksesueshme për të udhëhequr procesin do të jetë instrumentale.

Aty ku ekspertët/specialistët janë anëtarë të organeve statutore/rregullatore, proceset me të cilat ato organe certifikojnë kompetencën e anëtarëve duhet të jenë të disponueshme dhe transparente gjithashtu në mënyrë që të përmirësohet perceptimi i publikut dhe i familjes për besueshmërinë e specialistëve. Kur është e aplikueshme, duhet të jetë i disponueshëm akreditimi specifik i laboratorëve shkencorë të përdorur për ekzaminimin e mostrave ose materialeve njerëzore, së bashku me çdo procedurë ekzistuese shkencore, teknike dhe administrative të miratuar nga laboratorit.

Çdo kufizim për transparencën duhet të jetë rreptësisht i nevojshëm, në përputhje me të drejtat e viktimave dhe familjeve të tyre për dinjitet dhe konfidencialitet dhe t'i shërbejë një qëllimi legjitim, duke përfshirë sigurinë e të gjithë aktorëve dhe aktorëve potencialë të përfshirë.

(6) Komunikimi

Krijimi dhe ruajtja e strategjive dhe kanaleve të komunikimit (duke përfshirë edhe mediat sociale) me komunitetin e prekur, median dhe publikun e gjerë është thelbësore për realizimin e besimit, vullnetit të mirë dhe legjitimitetit për operacionin dhe do të mundësojë ofrimin e aspekteve të tjera jetike, duke përfshirë raportimin - si për varret ashtu edhe për të zhdukurit - si dhe angazhimin me proceset e identifikimit dhe hetimit. Komunikimi i qartë dhe i vazhdueshëm gjithashtu ofron platformën për transparencë. Strategjitë e komunikimit në mënyrë ideale duhet të parashikojnë dhe të përfshijnë një rrjedhë informacioni të dyanshëm dhe përditësime të rregullta.

(7) Pritshmëritë realiste

Familjet e të zhdukurve mund të kenë shpresa të mëdha se të dashurit e tyre do të identifikohen dhe do t'u kthehen atyre për përkujtim dinjitoz. Megjithatë, në praktikë, identifikimi dhe kthimi i mbetjeve njerëzore mund të mos jetë gjithmonë i mundur dhe pritshmëritë duhet të menaxhohen sa më shumë që të jetë e mundur për të siguruar angazhim dhe mbështetje të vazhdueshme për procesin e zhvarrosjes. Vështirësitë mund të jenë veçanërisht të theksuara në situatat kur mizoritë janë kryer në një shkallë të konsiderueshme, ku ka një mori varresh masive dhe personash të zhdukur, ku varret mbeten të pazbuluara dhe/ose ku kapaciteti dhe burimet e kufizuara mund të kufizojnë zhvarrosjen dhe/ose përpjekjet për identifikim. Të gjitha palët e përfshira në mbrojtjen dhe hetimin e varrit masiv duhet të shmangin marrjen e zotimeve ndaj familjeve, të cilat mund të mos arrijnë t'i mbajnë.

²⁴ Veçanërisht, kjo mund të sjellë adoptimin e qasjeve hetimore diferenciale në rastet, për shembull, të grave, të moshuarve, individëve të traumatizuar dhe/ose fëmijëve, ku ekzistojnë pabarazi apo vështirësi faktike në praktikë.

A. Zbulimi dhe raportimi i sigurt

Normat ndërkombëtare

Sipas ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, CED kërkon zbatimin e brendshëm të një të drejte kuptimplote për të raportuar, për të siguruar se një individ që pretendon se ka ndodhur një zhdukje me forcë, mund t'i raportojë faktet autoriteteve kompetente ndërkohë që i ofrohet mbrojtja e duhur (CED Neni 12(1)). Edhe pa një ankesë formale, për sa kohë që ka arsye të arsyeshme për të besuar se ka ndodhur një zhdukje me forcë, autoritetet duhet të hetojnë (CED, neni 12(2)).

Sipas ligjit ndërkombëtar humanitar, palët në konflikt duhet të regjistrojnë të gjitha informacionet identifikuese përpara varrimit të mbetjeve njerëzore dhe të shënojnë vendndodhjen e varrit (Rregullat e CIHL, Rregulli 116; GC IV, neni 130).

Fillimi i një hetimi në varr masiv mund të varet nga njoftimi i autoriteteve për praninë e dyshuar të një varri masiv. Sistemet e brendshme madje mund të përcaktojnë një detyrë për të raportuar.²⁵ Megjithatë, raporte të tilla mund të mos vijnë gjithmonë kur "informatori" (i cili mund të jetë ose jo i afërm i një personi të zhdukur) dëshiron të mbetet i pazbuluar nga, ose i panjohur për autoritetet.

Raportimi i sigurt: Kërkohet ofrimi i proceseve të sigurta për njoftimin e autoriteteve.²⁶ Individët ose agjencitë mund të jenë të parët që zbulojnë ose dëgjojnë raporte për një varr masiv të dyshuar. Raportimi mund të përfshijë ose duhet të shkaktojë regjistrimin e vendndodhjes së një varri masiv të dyshuar. Kjo mund të arrihet nëpërmjet shërbimeve dhe mjeteve gjeomatike që regjistrojnë koordinatat dhe vendndodhjet për të identifikuar vendet, si p.sh.

- Sistemi i Pozicionimit Global (GPS) ose Sistemi i Referencës së Rrjetit Ushtarak (MGRS);
- Hartat në një telefon celular;
- Meta-të dhëna nga fotografitë e marra me telefonat inteligjentë.

Dokumentimi paraprak i vendit mund të bëhet nëpërmjet:

- Fotografive;
- Video incizimit;
- Përshkrimeve të shkruara ose audio të një vendodhjeje;
- Vizatimeve ose identifikimit në një hartë.

Kjo mund të bëhet nga reaguesit e parë, reporterët ose vendasit që kanë parë një vend të mundshëm.²⁷ Kjo duhet të ndiqet nga agjencitë/zyrtarët investigative që

ndërmarrin një vlerësim fillestar të vendndodhjes. Pajisje si: dronët, satelitët dhe teknologjitë e tjera jo-invasive të skanimit, kur janë të disponueshme, mund të ndihmojnë më tej në dokumentacion.

B. Mbrojtja

Normat ndërkombëtare

Për të kryer një hetim efikas, duke përfshirë sigurimin e integritetit të provave të marra nga një vendndodhje, është thelbësore që një varr masiv të mos ngatërrohet ose të preket nga palët e treta (përfshirë ata që përgjigjen fillimisht). Neni 12(3)(a) i CED parashikon se autoritetet kanë "kompetencat dhe burimet e nevojshme për të kryer hetimin në mënyrë efektive, duke përfshirë aksesin në dokumentacion dhe informacione të tjera të rëndësishme për hetimin e tyre" (shtohet theksi).

Jurisprudenca e ligjit për të drejtat e njeriut thekson kujdesin e duhur dhe sugjeron që "autoritetet duhet të ndërmarrin hapat e arsyeshëm në dispozicion të tyre për të siguruar prova".²⁸

Sipas të drejtës ndërkombëtare humanitare, neni 34(2) i Protokollit Shtesë I kërkon mbrojtjen e varreve. Ekziston gjithashtu nevoja që "të merren të gjitha masat e mundshme për të parandaluar plaçkitjen e të vdekurve", me përdhosje ose gjymtim të trupave të vdekur që ndalohet kategorikisht (Rregullat e CIHL, Rregulli 113; ICC St. Neni²⁹ 8(2)(b)(xxi) dhe 8(2)(c) (ii) si krim lufte); dhe zhvendosja me respekt e trupave të vdekur, duke përfshirë respektimin dhe mirëmbajtjen e varreve (Rregulli 115) kërkohet.

Vjedhja nga të vdekurit, edhe pa veprën penale të vrasjes, përbën krim.³⁰

Mbrojtja e vendndodhjes është thelbësore për të ruajtur integritetin e mbetjeve, provave dhe linjave të hetimit, por në të njëjtën kohë mund të tërheqë vëmendjen ndaj varrit masiv si një vend me interes, duke rritur rrezikun e shkatërrimit të provave.

Zhvarrosja joeksperte mund të rezultojë në grumbullim të paplotë të provave të nevojshme për qëllime identifikimi dhe/ose hetimi penal, dështim në mbledhjen e të dhënave sipas standarteve të duhura të provave dhe rritje të dëmtimit të mbetjeve mortore pas vdekjes.

Rikuperimi jo i duhur i trupave mund të sjellë gjithashtu trajtim pa respekt (duke përfshirë shikimin publik) dhe të përkeqësojë traumën familjare. Mbrojtja mund të shmangë fotografimin dhe qarkullimin e imazheve të paautorizuara grafike dhe shqetësuese.

²⁵ Shihni, për shembull, Ligji i Irakut nr. 13 i 2015, Ligji për çështjet dhe mbrojtjen e varreve masive, Neni 9. Në mënyrë të ngjashme, Kodi Penal i vitit 2003 i Bosnjë dhe Hercegovinës që ndryshon Ligjin nr. 231a penalizon mosraportimin e një vendndodhjeje varri masiv me burgim (Bosnje dhe Hercegovinë: Kodi Penal (27 qershor 2003), Gazeta Zyrtare e Bosnjës dhe Hercegovinës 37/03).

²⁶ ICMP-ja, për shembull, ofron një Qendër të Kërkimeve Online dhe nëpërmjet "Site Locator" çdokush mund të raportojë në këtë mënyrë.

²⁷ Pajtuëshmëria me të Drejtat Globale (2016), Standartet Themelore të Hetimit për Reaguesit e Parë ndaj Krimeve Ndërkombëtare.

²⁸ Treskavica kundër Kroacisë, Vendim, GJEDNJ Kërkesa nr. 32036/13 (12 prill 2016) paragrafi 60, duke theksuar se kjo përfshin provat mjeko-ligjore. Informacioni se si të trajtohet një skenë e mundshme krimi gjendet në Manualin e vitit 2011 për asistimin e hetimeve penale ndërkombëtare në seksionin 7.1 mbi Sigurimin e vendit të krimit, faqe 65. Protokollat e Minesotës thonë se "[një] skenë krimi duhet të sigurohet sa më parë që të jetë e mundur dhe personelit të paautorizuar nuk do t'i lejohet hyrja" (faqe 14 në paragrafin 59).

²⁹ Statuti i Romës i Gjykatës Ndërkombëtare Penale (miratuar më 17 korrik 1998, hyrë në fuqi më 1 korrik 2002) 2187 UNTS 3 (shkurtuar ICC St.).

³⁰ Statuti i Romës i Gjykatës Ndërkombëtare Penale (miratuar më 17 korrik 1998, i cili hyri në fuqi më 1 korrik 2002) 2187 UNTS 3 (shkurtuar ICC St.).

³¹ Pohl et al. Gjykata Ushtarake e SHBA në Nuremberg (3 nëntor 1947).

Mbrojtja përfshin gjithashtu mbetjet njerëzore kundër kontaminimit, përdhosjes, grabitjes, pastruesve dhe lëvizjes/zhvendosjes së trupave në vendndodhje dytësore, ku autori kërkon të shmangë zbulimin. Shkelja e paautorizuar dhe ngatërrimi mund të përbëjë një vepër penale në sistemin vendas.³¹

Kushtet paraprake për një regjim efikas mbrojtjeje:

- Verifikimi i raporteve dhe provave nëpërmjet trekëndëshit me burime të tjera.
- Hartimi dhe dokumentimi i varreve masive në aspektin e shkallës së tyre dhe kontekstit lokal në të cilin ndodhen.

Hapat e nevojshëm të mbrojtjes mund të përfshijnë:

- Sigurimi i vendndodhjes dhe sigurimi i aksesit: duhet kërkuar dhe marrë leja ligjore³² për të hyrë në tokë. Kjo mund të kërkojë gjithashtu lidhje me komunitetin dhe pëlqimin në praktikë. Qasja mund të ndikohet nga prania e vendeve me rëndësi kulturore, faktorët gjeografikë dhe kontrolli. Rreziqet e natyrshme në një vendndodhje mund të përfshijnë mjete të pashpërthyer dhe ndotës.
- Masat mbrojtëse mund të përfshijnë: gardh për të siguruar perimetrat e jashtëm; mbulim horizontal për të mbrojtur mbetjet e shtrira në sipërfaqe dhe rojet e sigurisë dhe monitorimi në vend. Masa të tilla varen gjithashtu nga gjatësia kohore ndërmjet zbulimit dhe hetimit, konteksti lokal dhe cënueshmëria e zonës (d.m.th. ekspozimi ndaj elementeve dhe kafshëve). Sigurimi i vendndodhjes mund të kërkojë masa sigurie për ata që ofrojnë masa mbrojtëse, pasi ndjenjat publike mund të jenë kundër tyre.
- Akses i fizik mund të mos jetë gjithmonë i mundur për shembull kur hetuesit nuk mund të hyjnë në vend. Monitorimi jashtë vendit nëpërmjet imazheve satelitore mund të jetë masa e vetme mbrojtëse e disponueshme. Mbrojtja duhet të ofrohet pavarësisht nëse një vend është manipuluar apo jo.

C. Hetimi

Normat ndërkombëtare

Sipas ligjit të drejtave të njeriut, detyra për të kryer një hetim efikas do të thotë që hetimi duhet të jetë i pavarur dhe i përshtatshëm (për shembull, neni 12 i CED) për të përcaktuar faktet dhe për të identifikuar përgjegjësit.³³ Kjo përfshin sigurimin e provave mjeko-ligjore dhe autopsitë për një regjistrim të saktë dhe të plotë dhe analiza të pavarura të lëndimeve dhe shkakut të vdekjes.³⁴ Hetimi duhet të ketë autoritet të mjaftueshëm për të marrë informacione dhe për t'u kërkuar përgjegjësi zyrtarëve. Duhet të kryhet menjëherë; në përgjithësi, është një detyrim i vazhdueshëm për të hetuar³⁵, por një detyrim i mjeteve dhe jo i qëllimeve.³⁶ Gjykata Ndër-Amerikane e të Drejtave të Njeriut thekson nevojën për një hetim për të marrë në konsideratë kontekstin më të gjerë dhe kompleksitetin rreth ngjarjeve³⁷ për të arritur "të vërtetën më të plotë historike të mundshme", duke përfshirë përcaktimin e modeleve të veprimit kolektiv³⁸ në përputhje me të drejtën për të njohur të vërtetën (për shembull, neni 24(2) i CED). CED specifikon më tej në nenin 12(4) se shtetet anëtare duhet të "marrin masat e nevojshme për të parandaluar dhe sanksionuar aktet që pengojnë kryerjen e një hetimi". Kur është e përshtatshme, kjo mund të përfshijë bashkëpunimin ndërkombëtar ndërmjet shteteve dhe agjencive përkatëse (CED-Parimet Udhëzuese, Parimi 3(4)).

Hetimet që ndjekin qëllime thjesht humanitare mund të mos jenë "në vetvete të mjaftueshme për të përmbushur standartin e një hetimi efikas" siç kërkohej nga Neni 2 i Konventës Evropiane³⁹

Sipas Parimeve Orentlicher⁴⁰; "pavarësisht nga çdo procedurë ligjore, viktimat dhe familjet e tyre kanë të drejtën e papërshkrueshme për të ditur të vërtetën në lidhje me rrethanat në të cilat kanë ndodhur shkeljet dhe, në rast vdekjeje ose zhdukjeje, fatin e viktimave".

Sipas ligjit ndërkombëtar humanitar, familjet kanë të drejtë të informohen për fatin e anëtarëve të familjes së tyre dhe mund t'i drejtohen shtetit për dhënien e informacionit (neni 32 i Protokollit Shtesë I). Rregulli 117 i Rregullave të CIHL sugjeron që si për konfliktin e armatosur ndërkombëtar, ashtu edhe atë jondërkombëtar

³¹ Shihni, për shembull, Ligji i Irakut nr. 13 i vitit 2015, Ligji për çështjet dhe mbrojtjen e varrezave masive, që ndryshon Ligjin nr. 5 të 2006, Mbrojtja e varrezave masive.

³² Parimi 10(3) i Parimeve Udhëzuese 2019 për kërkimin e personave të zhdukur kërkon akses të pakufizuar tek autoritetet kompetente duke përfshirë "kompetencat e plota për të kryer vizita të paparalajmëruara në të gjitha vendet ku mund të jetë personi i zhdukur, duke përfshirë objektet ushtarake dhe policore dhe objektet private". Aty ku është e nevojshme, kjo duhet të përfshijë "ruajtjen e vendndodhjeve të rëndësishme për kërkimin" (po aty).

³³ Kukhalashvili dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë, Vendimi, GJEDNJ Kërkesa nr. 8938/07 dhe 41891/07 (2 prill 2020) paragrafi 129.

³⁴ Po aty, në paragrafin 129.

³⁵ Aslakhanova dhe të tjerët kundër Rusisë, Vendimi, Kërkesa GJEDNJ Nr. 2944/06 dhe 8300/07, 50184/07, 332/08, 42509/10 (18 dhjetor 2012) paragrafi 230.

³⁶ Da Silva kundër Mbretërisë së Bashkuar, Vendimi i Dhomës së Madhe, GJEDNJ Kërkesa nr. 5878/08 (30 mars 2016) paragrafët 231–238, duke dhënë një përmbledhje të plotë të kërkesave të Dhomës së Madhe për një hetim efikas.

³⁷ Masakra e "El Mozote" dhe vendeve të tjera kundër El Salvadorit, Gjykimi në themel, dëshmipërblimet dhe shpenzimet, Gjykata Ndër-Amerikane e të Drejtave të Njeriut Seria C Nr. 252 (25 tetor 2012) paragrafi 299.

³⁸ Valle Jaramillo et al. kundër Kolumbisë, Gjykimi në themel, dëshmipërblimet dhe shpenzimet, Gjykata Ndër-Amerikane e të Drejtave të Njeriut Seria C Nr. 192 (27 nëntor 2008) paragrafi 102.

³⁹ Qipro kundër Turqisë, Vendimi i Dhomës së Madhe, Kërkesa Nr. 25781/91 e GJEDNJ-së (10 maj 2001) paragrafi 135.

⁴⁰ Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, Raporti i ekspertit të pavarur për përditësimin e Paketës së Parimeve për të luftuar mosdëshkimin (18 shkurt 2005) UN Doc E/CN.4/2005/102/Add.1 (varianti i shkurtuar i Parimeve të Orentlicher-it) Parimi 4.

palët në konflikt “duhet të marrin të gjitha masat e mundshme për të llogaritur personat e raportuar të zhdukur”.

Udhëzimet e vitit 2019 për hetimet penale si rezultat i shkeljeve të së drejtës humanitare ndërkombëtare⁴¹ kërkojnë që standartet hetimore të jenë në përputhje me parimet e pavarësisë dhe paanshmërisë (Udhëzuesi 7); plotësisë (Udhëzuesi 8); shpejtësisë (Udhëzuesi 9) dhe transparencës (Udhëzuesi 10) të Gjykatës Penale Ndërkombëtare që kërkon nga hetuesit të “respektojnë standartet më të larta të integritetit dhe sjelljes”.⁴²

Hetimet e varreve masive mund të përbëjnë një pjesë integrale të një hetimi më të gjerë efikas për vdekjet potencialisht të paligjshme. Informacionet në lidhje me kontekstin e varreve masive, të ofruara nga dëshmitarët, anëtarët e komunitetit dhe të mbijetuarit, mund të mbajnë të dhëna të paçmueshme për mbrojtjen dhe hetimin e varreve.⁴³

Protokollet e Minesotës përcaktojnë kriteret minimale të mëposhtme për hetimin e vdekjeve potencialisht të paligjshme: “(a) Identifikoni viktimën(at); (b) Rikuperoni dhe ruani të gjitha materialet provuese për shkakun e vdekjes, identitetin e autorit(ve) dhe rrethanave të vdekjes; (c) Identifikoni dëshmitarët e mundshëm dhe merrni provat e tyre në lidhje me vdekjen dhe rrethanat e vdekjes; (d) Përcaktoni shkakun, mënyrën, vendin dhe kohën e vdekjes dhe të gjitha rrethanat përreth. (...) dhe (e) Përcaktoni se kush ishte i përfshirë në vdekje dhe përgjegjësinë e tyre individuale për vdekjen” (në D.1.25. faqe 7, shënimet në fund të faqes janë hequr).

Çështje të veçanta për t'u marrë në konsideratë në praktikën e mirë të hetimit të varreve masive:

Faza e planifikimit

1) Konsideratat e përgjithshme të planifikimit

- Cili ent ka përgjegjësinë e përgjithshme për varret masive në kontekstin e përpjekjeve më të mëdha për personat e zhdukur?⁴⁴
- Kush duhet të planifikojë procesin e zhvarrosjes, identifikimit dhe kthimit të mbetjeve njerëzore të varreve masive?
- Cili është qëllimi i hetimit të planifikuar?
- Cilat ekupe multidisiplinare duhet të mblidhen me çfarë nivelesh llogaridhënieje?⁴⁵
- Cilat ente ose autoritete shtesë mund të përfshihen dhe si do të bashkërendohen kolektivisht?
- Si përputhet hetimi i varrit masiv me aktivitetet e tjera/më të gjera hetimore?⁴⁶

2) Planet për aksesin e komunitetit dhe zbutjen e ndikimit negativ

- Krijimi i marrëdhënieve dhe besimit nëpërmjet shpjegimeve të marra në konsideratë në lidhje me qëllimin hetimor dhe proceset dhe menaxhimin e pritshmërive realiste është mjaft thelbësor. Ai do të ndihmojë në sigurimin e aksesit në vendndodhje, kontekst, informacion dhe pranim në praktikë.
- Planifikimi duhet të parashikojë dhe të kërkojë zbutjen e ndikimit në komunitet duke ruajtur integritetin e hetimit.

3) Planet për burimet, ekipin dhe prokurimin

Duhet të hartohet një buxhet dhe plan i qartë për burimet e disponueshme dhe të nevojshme për hetimin. Kjo do të përfshijë madhësinë dhe përbërjen e ekipit që do të vendoset, rolet e personelit (duke siguruar vazhdimësinë aty ku është e mundur) dhe fazën e rekrutimit.⁴⁷ Kur është e përshtatshme, duhet të merret në konsideratë angazhimi i hetuesve lokalë (duke përfshirë nevojat e trajnimit) për zhvillimin e kapaciteteve për periudha afatgjata.

4) Planet për sigurinë dhe sigurimin

Siguria e vendndodhjes, si dhe siguria fizike dhe psikologjike e personelit janë parësore. Disa vendndodhje mund të jenë shumë të rrezikshme për gjurmuesit⁴⁸ ose të pasigurta për shkak të kushteve të pafavorshme të motit. Ndihma e specializuar mund të jetë e nevojshme për rreziqe të tilla si: toksinat, minat tokësore dhe pajisjet shpërthyes të improvizuara (IED). Përveç sigurisë në vend, duhet menduar edhe për sigurinë gjatë transportit të personelit për në kantier dhe nga kantieri, si dhe gjatë kryerjes së punës ndërlidhëse.

5) Planet për objektin, shkallën dhe renditjen

Objekti, duke përfshirë afatet kohore dhe parametrat, për një hetim do të përfshijë konsideratat e shkallës dhe renditjes së gjurmëve dhe analizave të varreve masive.

6) Planet për Procedurat Standarte Operative dhe raportimin

Vënia në zbatim e Procedurave Standarte të Operacionit, standarteve dhe protokolleve të provave të pranura botërisht për trajtimin/përpunimin e provave dhe regjistrimin do të sigurojnë cilësi, qëndrueshmëri dhe transparencë të proceseve dhe duhet të jenë të pranueshme. Përveç kësaj, duhet të përgatitet për zbatim një sistem për kontrollin e cilësisë.

(7) Planet për faktorë të jashtëm

Ndotja, përzierja dhe “gjurmimi” i palës së tretë mund të ndikojnë në fazën e planifikimit.

⁴¹ Akademia e Gjenevës dhe Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) (2019), Udhëzime për hetimin e shkeljeve të së drejtës ndërkombëtare humanitare: ligji, politika dhe praktika e mirë.

⁴² Gjykata Ndërkombëtare Penale (2008), Kodi i Sjelljes për Hetuesit, ICC/AI/2008/005 seksioni 4.1.

⁴³ Protokolli i Minesotës, për shembull, ka një seksion për Intervistat dhe Mbrojtjen e Dëshmitarëve duke përfshirë një Udhëzues të Detajuar për Intervistat (në seksionin V, B. faqet 33-35).

⁴⁴ Kjo do të varet nga struktura institucionale, juridiksioni dhe mandati.

⁴⁵ Shihni Shtojcën 2 për disiplinën dhe ekspertët që mund të jenë pjesë e ekipit. Për informacion mbi rolet e menaxhimit si pjesë e Identifikimit të Viktimave të Fatkeqësive, shihni Shtojcën 8: Rolet e Menaxhimit DVI të Udhëzuesit të Interpolit për Identifikimin e Viktimave të Fatkeqësive.

⁴⁶ Dispozita e përgjithshme për zhvillimin e një hetimi për vdekjet potencialisht të paligjshme mund të gjendet në seksionin IV të Protokollet të Minesotës mbi zhvillimin e një hetimi (në faqet 12-15). Udhëzime të mëtejshme për hetimin e vendit të krimit mund të gjenden në Protokollet e Minesotës në seksionin V, faqet 30-32.

⁴⁷ Procedurat për të mbrojtur përvojën përkatëse, ekspertizën dhe përshtatshmërinë, si dhe zinxhirët rezervë të furnizimit mund të jenë pjesë e kësaj.

⁴⁸ UNAMI dhe OHCHR (2018) Zbulimi i mizorive: Varre masive në territorin e kontrolluar më parë nga ISIL.

(8) Planet për disponimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave

Në përputhje me objektin hetimor, duhet të përcaktohet disponimi (përdorimi dhe mbajtja në dispozicion) i mostrave të referencës, mostrave nga pjesët e trupit dhe provat përkatëse. Duhet të krijohen struktura të qarta për të gjitha të dhënat, duke përfshirë ruajtjen e tyre, mbrojtjen dhe ruajtjen e të dhënave, në përputhje me dispozitat e brendshme të të dhënave të shtetit, por edhe në përputhje me dispozitat ndërkombëtare.⁴⁹

(9) Planet për proceset e kthimit të mbetjeve njerëzore dhe/ose ruajtjen pas zhvarrosjes

Përpara se të fillojë zhvarrosja, duhet të ketë një strategji të qartë për proceset e kthimit të mbetjeve njerëzore dhe, në rast mosidentifikimi, duhet të merren masat e duhura për ruajtje ose varrim në mënyrë dinjitoze.

(10) Planet për strategjinë e komunikimit (duke përfshirë përdorimin e imazheve) dhe koordinimin

(10.1) Komunikimi i brendshëm, koordinimi dhe plani i duhur i zbatimit.

(10.2) Komunikimi dhe koordinimi i jashtëm ndërmjet grupit të hetimit dhe autoriteteve të prokurorisë gjyqësore; veçanërisht kur përpjekjet për identifikim njerëzor janë të ndara nga organet e prokurorisë kombëtare ose ndërkombëtare.

(10.3) Komunikimi dhe bashkërendimi i jashtëm ndërmjet grupit të hetimit dhe ndërlidhësve të viktimave, familjeve, komuniteteve dhe medias. Komunikimi i hershëm dhe i vazhdueshëm është thelbësor për zhvillimin e mbështetjes legjitime dhe angazhimit në procesin e zhvarrosjes. Kjo do të përfshijë sigurinë se mbetjet mortore do të trajtohen me kujdes, dinjitet dhe respekt dhe do të ruhen të sigurt. Kjo nga ana tjetër është jetike për realizimin e misionit të identifikimit dhe kthimit dhe është mbështetëse e besimit në ligj dhe pranimit të gjetjeve gjyqësore.

Të gjitha komunikimet me publikun duhet të jenë të sakta, të qarta, të rregullta dhe në kohë. Ato duhet të përfshijnë informacione mbi:

- Procesin e rikuperimit dhe kthimit të mbetjeve njerëzore;
- Ekzistencën (dhe përmbajtjen, sipas rastit) e protokolleve/masave të mbrojtjes dhe konfidencialitetit;
- Certifikatën e vdekjes;
- Disponueshmërinë e mbështetjes së duhur psikosociale për familjet; dhe
- Duhet të kërkojnë menaxhimin e pritshmërive

Qasja hetimore mjeko-ligjore

Në përputhje me fazat e planifikimit të mësipërm, qasja hetimore mjeko-ligjore do të kërkojë sa vijon:

(1) Vënien në zbatim të Procedurave Standarte të Operimit

Në çdo kohë dhe në të gjitha fazat, duhet të zbatohen Procedurat Standarte të miratuara të Operimit⁵⁰. Kjo do të ruajë integritetin e hetimit (veçanërisht në lidhje me identitetin e viktimave, gjetjen dhe ruajtjen e të gjitha provave të rëndësishme për identitetin, shkakun, mënyrën, kohën, vendin e vdekjes, lëvizjen dhe dëmtimin e mbetjeve njerëzore, si dhe identitetin e autorit(ve)).

(2) Përdorimi i mekanizmave të kontrollit të cilësisë

Një mekanizëm i kontrollit të cilësisë do të sigurojë që të respektohen të gjitha Procedurat Standarte të Operimit.

(3) Përdorimi i sistemit të duhur të përpunimit, regjistrimit, raportimit dhe ruajtjes së provave

Kjo do të përfshijë marrjen dhe transportimin e duhur, të sigurt dhe dinjitoz të mbetjeve njerëzore dhe masat për të shmangur kontaminimin. Të gjitha provat (në lidhje me shkakun, mënyrën dhe kohën e vdekjes, detajet demografike, numrin total të individëve, si dhe identitetet) duhet të ruhen, regjistrohen, analizohen dhe raportohen me ekspertizën e duhur, duke ruajtur një zinxhir të qartë kujdesi për identifikimin dhe proceset e mundshme të llogaridhënies.

(4) Përdorimi i strategjisë së komunikimit

Për të lehtësuar angazhimin efikas me kontaktin dhe ndërlidhjen familjare dhe, sipas rastit, bashkërendimin me institucionet e prokurorisë/gjyqësore dhe median.

⁴⁹ Të tilla si Deklarata Universale për Bioetikën dhe të Drejtat e Njeriut (UNESCO 2005), në lidhje me punën kërkimore në mjekësi, shkencat e jetës dhe teknologjitë shoqëruese, duke përfshirë gjenetikën; Deklarata Ndërkombëtare për të Dhënat Gjenetike të Njeriut (UNESCO 2003), në lidhje me mbledhjen, përpunimin, përdorimin dhe ruajtjen e të dhënave dhe mostrave gjenetike njerëzore; Deklarata Universale mbi Gjenomin e Njeriut dhe të Drejtat e Njeriut (UNESCO 1997), në lidhje me kërkimin, trajtimin ose diagnostikimin që prek gjenomi i një individi; Konventa për të Drejtat e Njeriut dhe Biomjekësi, Konventa e Oviedos (Këshilli i Evropës 1995), duke mbrojtur dinjitetin dhe identitetin e qenieve njerëzore në lidhje me biologjinë, mjekësinë, kërkimin biomjekësor dhe testimin gjenetik. Shihni gjithashtu aaBB Advancing Transfusion and Cellular Therapies Worldwide (2010), Udhëzues për Operacionet e Identifikimit të ADN-së të Fatalitetit Masiv për informacione mbi disponimin në kontekstin e përpjekjeve për identifikim (në faqen 11).

⁵⁰ Të tilla si Protokollet e Minesotës dhe në veçanti Udhëzimet e tij të Detajuara mbi Gërmimin e Varreve, në seksionin C faqet 36-37.

D. Identifikimi

Normat ndërkombëtare

Neni 15 i CED-së përcakton: “Shtetet Palë do të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe do t’i ofrojnë njëra-tjetrës masën më të madhe të ndihmës reciproke me synimin për të ndihmuar viktimat e zhdukjes me forcë, dhe në kërkimin, gjetjen dhe lirin e personave të zhdukur dhe, në rast vdekjeje, në zhvarrosjen dhe identifikimin e tyre dhe kthimin e eshtrave të tyre” (Vëmë theksin këtu). Informacione gjithashtu duhet t’u komunikohen personave me interes legjitim për informacione të tilla, siç janë të afërmit (po aty, neni 18). Dhe neni 24(3) i CED-së kërkon kthimin e mbetjeve njerëzore. Shtetet janë të detyruara të ofrojnë informacione, bazuar në dokumente, për personin e vdekur⁵¹ dhe të ndajnë burimet e nevojshme për gërmime në vendndodhjet e varrimit, duke përfshirë mbledhjen, ruajtjen dhe identifikimin e mbetjeve njerëzore.⁵² Lëshimi i një certifikate vdekjeje është më rëndësi të madhe.⁵³

Më tej, në rastin e Masakrës Pueblo Bello kundër Kolumbisë, Gjykata Ndër-Amerikane sugjeroi se shteti duhet të nxiste publikun që të sillte informacione që mund të ndihmonin në identifikimin e viktimave.⁵⁴ Është e njohur vlera e analizës së ADN-së si mjeti kryesor i identifikimit (The ICMP Paris Principles, Principle 6)⁵⁵

E drejta zakonore ndërkombëtare humanitare parashikon që palët në konflikt (qoftë ndërkombëtare apo jo ndërkombëtare) t’i kthejnë eshtrat e të vdekurve sipas kërkesës (Rregulli 114 i CIHL). Gjithashtu, “Çdo palë në konflikt duhet të marrë të gjitha masat e mundshme për të llogaritur personat e zhdukur si rezultat i konfliktit të armatosur dhe duhet t’u sigurojë anëtarëve të familjes së tyre çdo informacion që ka për fatin e tyre” (Rregulla 117 e CIHL).

KNKK-ja e zgjeron këtë qëndrim: “Pasi të jetë përcaktuar fati i një personi të zhdukur si: rasti i vdekjes, duhet të ndërmerren të gjitha mjetet e disponueshme për të siguruar rikuperimin e trupit dhe çdo gjëje personale” (Ligji Model i KNKK-së për të Zhdukurit, Neni 19).

19). Dispozitat mbulojnë gjithashtu praktikën e

nevojshme të varrimit, zhvarrosjes dhe përkujtimit dhe mënyrën e trajtimit të mbetjeve njerëzore të pidentifikuara, duke kërkuar që të mbahen shënime, të vazhdojnë përpjekjet për identifikimin dhe familja të mbahet e informuar.

Ndërsa identifikimi përbën një aspekt thelbësor të hetimeve dhe realizimit të të drejtave, ai zakonisht kuptohet si një detyrim mjetesh.⁵⁶ Identifikimi i mbetjeve njerëzore është një parakusht për kthimin e eshtrave në familje për të lehtësuar praktikën përkujtimore, por edhe për familjen që të marrin certifikatën e vdekjes.⁵⁷

Kriteret në vendndodhje:

Marrja, regjistrimi dhe ruajtja e mbetjeve njerëzore dhe dëshmive të lidhura me to duhet të jenë në përputhje me dispozitat e përshkruara në seksionin për hetimin.

Përpjekjet jashtë vendndodhjes:

Ekzaminimi post-mortem (pas vdekjes)⁵⁸ dëshmitë e lidhura me to ndërmerren në morg. Një punë e tillë zakonisht kërkon planifikim specifik dhe shpërndarje të burimeve shtesë. Përveç kësaj, kërkohet sa vijon:

- Mbajtja e një zinxhiri të qartë kujdestarie për proceset e identifikimit dhe llogaridhënies;
- Objekte të mjaftueshme për mbajtjen dhe ruajtjen e mbetjeve njerëzore; dhe
- Kapaciteti për familjet që vizitojnë morgun për të identifikuar dhe/ose për të parë provat përkatëse.

Mbledhja e të dhënave për personat e zhdukur, përfshirë mostrat e referencës së ADN-së të familjes, kërkohet për të gjeneruar informacion për të lehtësuar identifikimin. Këto të dhëna duhet të mbledhen në mënyrë sensitive që mbron të drejtat e të mbijetuarve dhe të të ndjerit. Praktika të tilla në lidhje me të dhënat personale, informacionin gjenetik dhe ruajtjen e një informacioni të tillë duhet të jenë në përputhje me dispozitat e brendshme të të dhënave dhe të jenë të njohura me standardet ndërkombëtare.

⁵¹ Masakrat e El Mozotes dhe vendeve të tjera kundër El Salvadorit, Gjykimi në themel, dëshmipërblimet dhe kostot, Gjykata Ndër-Amerikane e të Drejtave të Njeriut Seria C Nr. 252 (25 tetor 2012) paragrafi 334.

⁵² Aslakhanova dhe të tjerët kundër Rusisë, Gjykimi, Kërkesa nr. 2944/06 dhe 8300/07, 50184/07, 332/08, 42509/10 në GJEDNJ (18 dhjetor 2012), paragrafi 226.

⁵³ Lëshimi dhe përpunimi i certifikatave të vdekjes ishte në qendër të Konventës së OKB-së mbi Deklarimin e Vdekjes së Personave të Zhdukur pas Luftës së Dytë Botërore (1939-1945), e cila ishte në fuqi deri në vitin 1972. Ligji Model i KNKK-së për të Zhdukurit shpjegon në komentarin e tij për nenin 4 “Në rast vdekjeje, ekziston detyrimi për të siguruar një certifikatë vdekjeje, për të trajtuar eshtrat njerëzore me respekt dhe dinjitet, si dhe për t’i kthyer trupin familjes dhe/ose për të siguruar varrimin” në faqen 12) dhe duhet të kryhet nga autoriteti kompetent (në faqen 44). Më tej, certifikatat e vdekjes identifikohen në Menaxhimin e KNKK-së për Trupat e Vdekur pas Fatkeqësive: Një Manual në terren për Reaguesit e Parë, për shembull, në faqen 30; dhe Interpol, Identifikimi i Viktimave të Fatkeqësive, në 5.4. Faza 4: Pajtimi, në faqen 17.

⁵⁴ Masakra e Pueblo Bello në Kolumbi, Gjykimi në themel, dëshmipërblimet dhe shpenzimet, Gjykata Ndër-Amerikane e të Drejtave të Njeriut Seria C Nr. 140 (31 janar 2006) paragrafi 272.

⁵⁵ Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (2019), Parimet e ICMP Paris, Versioni me shënime, ICMPDG.468.1.W.doc.

⁵⁶ Megjithatë Udhëzuesi i Interpolit për Identifikimin e Viktimave nga Fatkeqësitë sugjeron një qasje më kategorike duke përcaktuar: “Viktimat kanë të drejtën e identitetit pas vdekjes së tyre” (Pjesa B, Shtojca 2, Letra e Bardhë - DVI).

⁵⁷ Një përjashtim është ligji argjentinas nr. 14,321 i datës 11 maj 1994, i cili krijon një kategori të zhdukurve me forcë si një ekuivalent ligjor me vdekjen për qëllime civile. I lejon familjet të përpunojnë testamentet, të merren me pasurinë e të zhdukurve dhe çështjet e trashëgimisë, por mundësia e “rishfaqjes” së individit mbetet e hapur. Një deklaratë e tillë pranon në thelb përfshirjen ose përgjegjësinë e shtetit për vdekjen e individit (ndryshe nga thjesht një certifikatë vdekjeje).

⁵⁸ Për shembull, në përputhje me Udhëzuesin e Minesotës për Autopsinë, i cili ofron udhëzime për autopsitë, ekzaminimin dentar dhe analizën antropologjike të mbetjeve skeletore, siç përmbahet në Udhëzuesin E në faqet 49-51 si dhe Shtojcat 1-5, faqet 57-87 që ofrojnë formularë. Këto mund të zhvillohen në objekte të sigurta të përkohshme mortore.

- Sistemi i menaxhimit të të dhënave për të përputhur të gjitha aspektet e mbledhjes dhe analizës së të dhënave është gjithashtu një kërkesë jashtë vendndodhjes për të lehtësuar identifikimin. Si minimum, kjo do të përfshijë:
- Një regjistër i personave të zhdukur dhe informacione shoqëruese;
- Informacione duke përfshirë mostrat e referencës së ADN-së nga familjet e të zhdukurve;
- Të dhëna mbi operacionet e arkeologjisë mjeko-ligjore dhe gjetjen e mbetjeve njerëzore dhe dëshmitë përkatëse;
- Ekzaminimi antropologjik dhe inventarizimi i rasteve;
- Proceset laboratorike të ADN-së;
- Baza e të dhënave të profilit të ADN-së; dhe
- Përputhja e ADN-së.

Kapaciteti i përpunimit të ADN-së nuk duhet të ekzistojë brenda vendit, sepse ai mund të jetë i disponueshëm nëpërmjet organizatave të palëve të treta, të cilat mund të ofrojnë ndihmë për testimin e ADN-së në një shkallë të gjerë.

Strategjia e komunikimit do të lehtësojë:

- Shpjegimin e proceseve dhe afateve kohore të identifikimit dhe përpunimit të të dhënave për anëtarët e familjes dhe komunitetin e gjerë për të gjeneruar pranim;
- Mbajtjen e familjeve të informuara për vendimet në lidhje me ekzaminimet pas vdekjes dhe rezultatet e çdo ekzaminimi të tillë. Kjo duhet të përfshijë informacion mbi mbështetjen e familjes dhe opsionet e referimit;
- Komunikimin efikas me agjencitë që mund të mbajnë dhe ofrojnë informacione plotësuese;
- Komunikimin efikas me median që respekton të drejtat e privatësisë së familjeve të prekura, njeh ndjeshmërinë e familjeve dhe të drejtën për të ditur rezultatet përpara komunikimit të tyre në media.

Rezultatet e mundshme të përpjekjeve për identifikim

(1) Identifikimi pozitiv: konstatohet kur ka përputhje midis të dhënave ante-mortem dhe post-mortem të një personi të zhdukur dhe nuk ka mospërputhje që nuk mund të shpjegohen.

Duhet të përdoren metoda shkencore të besueshme për identifikimin, duke përfshirë gjurmët e gishtërinjve, ekzaminimin dentar, një profil biologjik nëpërmjet ekzaminimit antropologjik ku skeletizohen mbetjet dhe kryhet analiza e ADN-së.

Njohja vizuale (duke përfshirë atë nga fotografitë), përshkrimi personal, tatuazhet, pronat dhe veshjet e gjetura në trup, si dhe gjetjet mjekësore mund të shërbejnë për të mbështetur identifikimin, por duhet të shmangen si identifikues i vetëm.⁵⁹

Aty ku është konstatuar identifikimi, autoriteti përkatës duhet të lëshojë një **certifikatë vdekjeje**⁶⁰.

(2) Identifikimi nuk është konstatuar: kur, për shembull, provat mbështesin përjashtimin e një hipoteze të veçantë në lidhje me identitetin e mbetjeve njerëzore, ose kur nuk ka një përfundim për identifikimin e mbetjeve njerëzore.⁶¹

Një procesverbal duhet të mbahet aktiv për të lejuar identifikimin dhe njoftimin e mëvonshëm të të afërmeve dhe palëve të interesuara, duke përfshirë autoritetet shtetërore. Nevojiten masa ruajtjeje dhe magazinimi afatgjatë për të mbrojtur perspektivën e identifikimit në të ardhmen. Kur masat e ruajtjes dhe mbrojtjes janë të padisponueshme ose të papërshtatshme, mbetjet njerëzore të paidentifikuara mund të varrosen në varre të shënuara sipas zakoneve të mundshme kulturore ose të përshtatshme fetare të të ndjerit.⁶²

Me qëllim që të sigurohet mundësia e identifikimit, në të ardhmen, kudo që është e mundur, duhet të shmangët djegia.

Gjurmueshmëria e mbetjeve duhet të sigurohet nëpërmjet metodave të tilla, si:

- Dokumentimi dhe hartëzimi i vendndodhjes, duke përfshirë hartën e vendndodhjes së trupave brenda zonës;
- Numërimi dhe etiketimi i secilit trup dhe qese/arkivoli duke iu referuar numrit dhe ruajtjes së mostrës së ADN-së;
- Përdorimi i tabelave për të shënuar vendndodhjen;
- Ruajtja e sigurt e informacionit për të garantuar sigurinë e tij.

(3) Identifikimi i gabuar: kur ka një gabim në atribuimin e identitetit ndaj mbetjeve njerëzore. Një keqidentifikim i tillë do të ketë efekte negative në të dyja grupet e familjeve të përfshira, si dhe në hetim.

Zbulimi i një gabimi të tillë duhet të shkaktojë lidhjen dhe mbështetjen e duhur familjare, si dhe veprime korrigjuese në përputhje me Procedurat Standarte të Funksionimit.

Të drejtat familjare në rastet e mosidentifikimit

Në rastin e mosidentifikimit, anëtarët e mbijetuar të familjes mund të kërkojnë një certifikatë për të vërtetuar mungesën e të dashurve, gjë që u mundëson atyre të kërkojnë të drejta të tjera ose të vazhdojnë me shitjen e pasurive, trashëgiminë, rimartesën etj. Një status ose certifikatë mungese duhet të lëshohet për të mbrojtur të drejtat e familjeve.⁶³

⁵⁹ Shihni Metodën e Identifikimit (Parësore dhe Dytësore) si pjesë e Udhëzuesit të Interpolit për Identifikimin e Viktimave të Fatkeqësive në faqen 18; Udhëzuesi i Interpolit për Identifikimin e Viktimave të Fatkeqësive Shtojca 12 mbi Metodën e Identifikimit dhe Protokolli i Minesotës, seksioni E mbi identifikimin e trupave të vdekur, faqet 21-24.

⁶⁰ Si, për shembull, modeli i certifikatës së vdekjes në Aneksin 2 të KNKK-së/Modeli i Ligjit për të Zhdukurit.

⁶¹ Shihni Protokolli i Minesotës, seksionin E mbi identifikimin e trupave të vdekur, faqe 24.

